



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

MBI

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT  
VETËDEKLARUES Z.QAZIM HALIL BICI, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK TË  
BASHKISË SHIJAK, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR PARTIA “DREJTËSI INTEGRIM  
DHE UNITET”**

Sot më datë .05.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

**Objekt:** Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qazim Halil Bici, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet” për Bashkinë Shijak.

**Baza ligjore:** Nenet 5, 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Data: 2023 Nr:  
Ora:



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qazim Halil Bici, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Drejtësi dhe Integrim dhe Unitet” për Bashkinë Shijak

## V Ë R E J:

- (1) Në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak”.
- (2) Me vendim të KQZ, z. Qazim Halil Bici, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin e Bashkisë Shijak, i mbështetur nga Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet”.

Për këtë kandidat në datën 29.03.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. Unik DR-PDIU-8438. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, KQZ ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ-së, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet komunikimit elektronik ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Qazim Halil Bici, ku konstatohet se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

(3) Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Qazim Halil Bici, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues nuk ka deklaruar gjenealitete të mëparshme.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj,? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar: “Verona”.
- Pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar: “Verona”.
- Pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po”.
- Pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po”.

Data: 2023 Nr:  
Ora:



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qazim Halil Bici, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Drejtësi dhe Integrim dhe Unitet” për Bashkinë Shijak

- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar : Se ka jetuar në Itali, Gjermani, Norvegji, për arsye punësimi.

(4) Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, KQZ çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

#### **V E N D O S:**

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Qazim Halil Bici, kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet” për Bashkinë Shijak dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 2023 Nr:  
Ora:



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qazim Halil Bici, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Drejtësi dhe Integrim dhe Unitet” për Bashkinë Shijak